

Data 25/09/2023

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Blerje Kompjuterash dhe Printera

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Kompjutera Desktop, Printer Lazer .

---

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 1,446,414 (Një milion e katërqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e katërbëdhjetë ) lekë pa tvsh.

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujesjelles Kanalizime Kamez Sh.aka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së (Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së kontratës përkatësisht 578,565.6 leke pa tvsh.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Është kërkuar vlera maksimale prej 40% e fondit limit pasi është vlerë lehtësisht e përballueshme nga OE .

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022, të konfirmuara nga Organet tatimore shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar (vetëm në rastin kur janë objekt i nenshkrimit të auditimit), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht,

Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. “

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

Janë kërkuar vetëm bilancet e dy viteve financiare për ti mundësuar AK vlerësimin nëse OE ka një aktivitet pozitiv dhe garanton kështu realizimin me sukses të kontratës.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht 289,282.9 leke pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

---

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (të përkthyer dhe noterizuar).

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 27001:2013 (ose e përditësuar) për Menxhimin e Sigurisë së Informacioneve, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (të përkthyer dhe noterizuar).

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO/IEC 20000-1:2011 (ose e përditësuar) për Menaxhimin e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (të përkthyer dhe noterizuar).

**2.3.5** Operatori ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën ROHS për pajisjet e ofertuara (të përkthyer dhe noterizuar).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi ose nga distributori i autorizuar, për shitjen/rishitjen për paisjet e ofertuara në këtë objekt prokurimi për territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie

kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

**2.3.7.** Operatori ofertues duhet të paraqesë katalog (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar) për çdo produkt, ku në katalogët përkatës të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjëjmë pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, përveç elementëve teknik specifik, termave në anglisht që përdoren ndërkombëtarisht, që janë vendosur në specifikimet teknike (shih specifikimet teknike).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. AK ka kërkuar katalogët e mallit që do të ofrohet nga OE për të vërtetuar se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesa për katalogët e produktit ka rëndësi specifike për këtë procedurë prokurim pasi objekti I prokurimit janë blerje kompjutera dhe printera dhe specifikimet teknike të produktit kanë një rëndësi të madhe për sa I përket kushteve të punës që ato kryen në këto institucion, katalogu I produktit lehtëson punën e ak për të verifikuar nëse produkti I ofruar nga OE plotëson standartet e përcaktuara nga AK në përputhje me përcaktimet e AKSHI

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 3 (tre) punonjës të siguruar, ku përfshihen specialist, të çertifikuar në nivel teknik **ose ekuivalentët e këtyre çertifikimeve, lëshuar nga autoritete të çertifikuara për t'i dhënë ato** për pajisjet e ofruara në mënyrë që të realizohet me sukses qëllimi i procedurës.

Për të vërtetuar sa më sipër operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata përkatëse
- Listëpagesat për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

*Shenim:* Per këte pike 2.3.8 te mesiperme operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

*Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në këte nen, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e ketij kriteri eshte bere ne perputhje me zerat e preventivit.

**2.3.9** Pajisjet duhet të jenë të reja (JO Refurbished). Për këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë.

**2.4.0** Operatori ekonomik deklaron se do të kryejë furnizimin, instalimin, implementimin e testimin e pajisjeve në rrjetin aktual sipas nevojës dhe vendit ku autoriteti kontraktor përcakton.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Te gjitha specifikimet teknike jane gjetur tek faqja e AKSHI-t, tek Specifikimet Teknike Standarte.

# PRINTER

B&W Standard

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
Shpejtësia e Printimit "Print Speed" A4:	≥ 35 ppm
Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":	20 000 Faqe
Teknologjia "Technology":	Laser
Rezolucioni i Printimit Minimal "Print Quality":	1200x600 dpi
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity":	250 Fletë
Pesha Specifike e Letrës "Media Sizes":	60-120 g/m <sup>2</sup>
Formati i Letrës "Media format":	A4/A5/Envelope
Aftësia e Printimit Duplex:	Po
Memorja "Memory":	≥ 256 MB
"Toner":	Shoqëruar me Starter Kit
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
Porta e Komunikimit "Interface":	High Speed USB 2.0
"Ethernet":	Po
<b>AKSESORËT</b>	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD:	Po
Kabëll USB:	Po
<b>GARANCIA</b>	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	2 Vjet
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri	

# KOMPJUTERA

## Desktop 1

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	7900 Pikë
"RAM":	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":	500 GB SSD
"Disk Subsystem Controller":	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike "Graphics":	Integrated graphic Card, min. 1 GB
"Media Device":	DVD+/-RW
"Slots":	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit "Ports":	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
Rrjeti "Networking":	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
"Sound":	Integrated Sound Card
"Speakers":	Internal or Built-in Monitor
Siguria "Security Management":	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera "Keyboard":	Standart Keyboard QWERTY
"Mouse":	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi "Power Supply"	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
"Recover":	Recover Partition
MONITORI	
Tipi "Type":	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia "Size":	≥ 21"
Rezolucioni "Native Resolution":	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontratit "Constrast Ratio Static":	1000:1
"Display Port":	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit "Response Time":	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	3 Vjet



# PROJEKTOR

Tipi 1

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
Tipi "Type":	DLP ose LCD ose Ekuivalente
Ndriçimi "Brightness":	3000 ANSI Lumen
Rezolucioni "Resolution":	WXGA 1280 x 800
Përputhshmëria Video "Video Compatibility":	NTSC/PAL
Jetëgjatësia e Llampës "Lamp Life":	6000 Orë, Standard
Raporti i Kontrastit "Contrast Ratio":	5 000 : 1
Rregullimi i Lenteve "Lens Adjusting":	F Number, Zoom Manual, Focus Manual
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
Portat Hyrëse "Input Terminal":	(1) VGA, (1) HDMI, (1) USB
<b>AKSESORËT</b>	
Kabëll "Power Cord":	European
Telekomandë "Remote Control":	Po
Kabuj të Përfshirë "Included Cords":	(1) VGA – VGA, (1) HDMI – HDMI; Kabujt duhet të kenë gjatësi min. 3 m
CD Manual Përdoruesi "CD User Manual":	Po
Çanta "Carrying Bag":	Po
<b>GARANCIA</b>	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	2 Vjet

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	4500 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	8 GB, DDR4 min. 2133 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:	256 GB SSD
“Graphics”:	Integrated Graphics with 1 GB Video Memory
Ekrani “Display”:	15.6” LED FHD (1920 x 1080), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 45 Wh
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.0
“Sound”:	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
<b>AKSESORËT</b>	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”:	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
<b>GARANCIA</b>	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
"Model":	Copier/Printer
Shpejtësia "Copy/Print Speed for A4":	≥ 20 ppm
Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":	≥ 5 000 Faqe
Teknologjia "Technology":	Laser B&W
Zvogëlim/Zmadhim "Reduction/Enlargement":	25%-200%
Vendosja e Dokumentit "Document Feeder":	ADF
Sirtarët për Letrën "Paper Trays":	1
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity min":	250 Fletë
Kapaciteti në Dalje "Output Capacity min Standard":	100 Fletë
Kopjim/Printim në të dy Faqet "Duplex Copying/Print.":	Nuk Specifikohet
Formati i Letrës "Media Sizes":	A4
Memorja "Memory":	≥ 128 MB
"Hard Disk":	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit "Scan Speed":	Nuk Specifikohet
Rezolucioni i Skanimit "Scan Resolution":	Nuk Specifikohet
Formati i Skanimit Maksimal "Maximum Scan Size":	Nuk Specifikohet
"Toner":	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit "Interface":	High Speed USB 2.0
"Ethernet":	Po
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD :	Po
Kabëll USB:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	1 Vit ose 15 000 Kopje*
<b>*Kush të arrihet më parë</b>	
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	



KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
<b>DALJE "OUTPUT"</b>	
Fuqia "Power":	1000 VA
Faktori i Fuqisë "Power Factor":	≥0.8
Forma e Valës "Wave Form":	Sinusoidale
Tensioni Nominal "Nominal Voltage":	220-240 V AC
Frekuenca "Frequency":	50 Hz +/- 5%
Rregullimi i Tensionit "Volt, Regul. (On Battery)":	+/-10%
Prizat Dalëse "Output Connectors":	≥ (4) IEC 320 C13 (nga bateria)
<b>HYRJE "INPUT"</b>	
Tensioni nominal "Nominal Voltage":	220 - 240 V AC
Frekuenca "Frequency":	50 Hz
Dritarja e Tensionit "Voltage Window":	170 - 270 V AC
Rregullim Automatik i Tensionit "AVR":	Po
Prizat Hyrëse "Input Connectors":	(1) IEC 320 C14
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
Programi i Fikjes "Shutdown Software":	Po
Sinjalizim me LED "Led Indicators":	Për të gjitha gjendjet
Sinjalizim me Zë "Audible Indicators":	Për të gjitha gjendjet
Porta e Komunikimit "Interface":	(1) DB9 Serial ose USB
Mbrojtja "Protection":	Overload, Discharge, and Overcharge Protection
<b>BATERITË</b>	
Koha e Transferimit "Transfer time":	≤4 ms
Koha e Funksionimit me Bateri "Back-Up Time":	≥6 min. Me ngarkesë të plotë
Tipi i Baterive "Battery Type":	12 V DC 7 Ah Lead-Acid
<b>AKSESORËT</b>	
Kabëll për Linjën Kryesore "Power Cord":	(1) European IEC-C13
Kabëll për Lidhjen e PC "PC Power Cord":	(2) IEC 320 C13 - IEC 320 C14
Kabëll për Komunikimin e të Dhënave "Data Cable":	(1) DB9 Serial - DB9 Serial ose USB - USB
<b>GARANCIA</b>	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	2 Vjet

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar). Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe

janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është:**

Data: **06/10/2022**; Ora: **10:00**; Vendi: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**NJESIA E PROKURIMIT**